

18.02.2022
Ora 14:46

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për kriteret e caktimit të numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave”.


PJESËMARRJA :

KQZ:

- Ilirjan **CELIBASHI** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana **NANO** Kryetar
- Arens **ÇELA** Anëtar
- Dritan **ÇAKA** Anëtar
- Helga **VUKAJ** Anëtar
- Muharrem **ÇAKAJ** Anëtar
- Stafi **KQZ** Y.Merkaj, M.Koja, E.Meta
- Parti **Politike:** LSI (A.Kaziaj)

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit, përfaqësues të subjekteve zgjedhore, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rendin e ditës së mbledhjes kemi shqyrtimin e dy projektvendimeve, i pari “Për kriteret e caktimit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave”, dhe projektvendimi i dytë “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjate dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*


zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjeshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”. Paraprakisht më lejoni të pyes kolegët dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës që do donin t’i diskutonim. Kolegë? Zoti Kaziaj? Nuk ka çështje jashtë rendit të ditës! Fillojmë me projektvendimet që kemi në rendin e ditës. Të dy projektvendimet kanë ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kështu që Sekretar i Përgjithshëm, zoti Merkaj, do të lutesha të fillonim me një prezantim të përmbledhur, të shkurtër, të projektvendimit të parë “Për kriteret e caktimit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave”.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Në përmbushje të kompetencës së parashikuar, neni 20, paragrafi a, shkronja “a” dhe “b” si dhe neni 95 të Kodit Zgjedhor, Komisionit Rregullator i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi për kriteret e caktimit të grupit të numërimit për çdo vend të numërimit të votave. Projektvendimi ka për qëllim të detajojë kriteret për përcaktimin e numrit të grupit të numërimit të votave për çdo vend të numërimit të votave në përputhje e parashikimet e Kodit Zgjedhor të ndryshuar. Projektvendimi është strukturuar në 3 krerë, si më poshtë:

Kreu i parë. Të përgjithshme, ku pasqyrohen qëllimi, parime të përgjithshme, caktimi i numrit të grupeve të numërimit të votave.

Kreu i dytë është emërtimi i anëtarëve të grupit të numërimit të votave, ku pasqyrohet papajtueshmëria me detyrën e anëtarit të grupit të numërimit të votave. Kushtet për emërimin e anëtarit të GNV-së, paraqiten propozimet nga partitë politike, emërimi i anëtarëve të GNV-së, procedura për përzgjedhjen, për numëruesin e parë dhe sekretarin e grupit të numërimit të votave, zëvendësimin e anëtarëve të grupit të numërimit, procedurat e shortit për zëvendësimin e anëtarit të GNV-ve si dhe plotësimi i vakancës.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

Kreu i tretë është hyrja në fuqi dhe ankimi. Bashkëlidhur keni për shqyrtim dhe miratim, projektvendimin e mësipërm, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Fillojmë me shqyrtimin në parim të projektvendimit. Unë paraprakisht do thoja që në zgjedhjet e kaluara, pra në zgjedhjet për Kuvend, të 25 Prillit 2021, ne kemi miratuar një projektvendim për kriteret e caktimit të numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, por që ka qenë një vendim i posaçëm për zgjedhjet për Kuvend. Ky projektvendim që po shqyrtojmë sot është një projektvendim, i cili vlen për çdo lloj zgjedhjeje, qoftë për Kuvend, qoftë për zgjedhjet vendore, qoftë zgjedhje të pjesshme apo të parakohshme, për aq sa nuk ndryshon Kodi Zgjedhor, këto do duhet të jenë rregulla për secilën nga zgjedhjet. Kolegë, lidhur me projektvendimin në parim, keni diçka? Zoti Kaziaj? Jo! Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Janë 12 nene të këtij vendimi. Neni 1. Qëllimi. Kemi diçka? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka


Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 2. Parime të përgjithshme. Ndonjë pyetje? Nuk ka! Kalojmë në votimin e nenit 2.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 3. Caktimi i numrit të grupeve të numërimit të votave. Me sa shoh dhe në afat jemi korrekt edhe sa i përket këtyre zgjedhjeve, pra, 13 ditë para ditës së votimit caktohet numri i grupit të numërimit të votave nga KZAZ-të. Kolegë, kemi ndonjë pyetje apo propozim për nenin 3? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 3.

Kush është dakord?

Pro: *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Kreu 2. Emërimi i anëtarëve të grupeve të numërimit. Neni 4. Papajftueshmëritë me detyrën e anëtarit të GNV-së. Çështje për diskutim? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 4.

Kush është dakord?

Pro: *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 5. Kushtet për emërimin e anëtarit të GNV-së. Zoti Kaziaj, kolegë, ndonjë pyetje, sqarim, propozim, jo? Kalojmë në votimin e nenit 5.

Kush është dakord?

Pro: *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 6. Paraqitja e propozimeve nga partitë politike. Sigurisht dhe ky nen ka ndjekur logjikën e parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Edhe këtu afatet janë të atilla që përfshijnë edhe zgjedhjet e pjeshme. Kemi ndonjë propozim? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 6.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 7. Emërimi i anëtarëve të grupeve të numërimit të votave. Dhe këtu kemi një afat. Është afati 10 ditor para datës së zgjedhjeve dhe modeli tip për emërimin e anëtarëve, i cili, më lejoni të pyes, është miratuar aktualisht nga Komisioneri apo do të miratohet?

Z. Y. Merkaj: Është miratuar!

Znj. I. Nano: Është miratuar. Kështu që edhe në këto kushte jemi në situatën kur edhe paraprakisht e kemi vendimin tip, në çdo rast do të kishte kohë edhe nëse nuk do të ishte miratuar.

Kush është dakord, kolegë, me nenin 7?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka


Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 8. Procedura e zgjedhjes për numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-ve. Lidhur me këtë proces, nëse mundet të na bëjë me dije administrata, për vendimmarrjen e deritanishme të Komisionerit, për numëruesin, anëtarin e tretë dhe të katërt.

Z. Y. Merkaj: Po, është përcaktuar me vendim.

Znj. I. Nano: Janë përcaktuar. Kështu që le të themi për këto zgjedhje që kemi në prag edhe këto procedura janë ezauruar tashmë.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 8 sipas propozimit të ardhur?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 9. Zëvendësimi i anëtarëve të grupit të numërimit. Parashikohen rastet kur një parti politike nuk paraqet propozim brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 6 që ne sapo miratuam dhe caktimin e anëtarëve zëvendësues nga ana e KZAZ-së.

Kush është dakord me nenin 9?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 10. Procedura e shortit për zëvendësimin e anëtarëve të GNV-ve. Kemi ndonjë sqarim? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 10.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 11. Plotësimi i vakancës. Nuk ka pyetje! Nuk ka propozime! Kalojmë në votim.

Kush është dakord me nenin 11?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kreu 3. Hyrja në fuqi. Neni 12. Hyrja në fuqi dhe ankimimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

***Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)*

***Kundra:** S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Duke qenë që e kemi miratuar projektvendimin në parim dhe nen për nen kalojmë në votimin në tërësi. Sikundër u vërejt nuk pati asnjë ndryshim, as propozime, madje as për shtesa apo ndryshime. Votojmë në tërësi projektvendimin “Për kriteret e caktimit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave”.

Kush është dakord?


***Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)*

***Kundra:** S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Vendim nr. 20

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



18.02.2022
Ora 14:56

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje që do të zhvillohen me datë 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

KQZ:

- Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y.Merkaj, M.Koja, E.Meta
- Parti Politike: LSI (A.Kaziaj)

Znj. I. Nano: Kalojmë në projektvendimin e dytë, gjithashtu i një rëndësie të veçantë dhe një akt i posaçëm për këto zgjedhje, “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor, për zgjedhjet e pjesshme për

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”. Zoti Merkaj ju lutem një prezantim të përmbledhur të projektaktit, i cili duhet thënë është voluminoz, ndërkohë shoqërohet edhe me një aneks bashkëlidhur që janë modelet e fletëve të pavlefshme të votimit, të cilat për ata që na ndjekin, po shfaqen ndërkohë edhe në monitor. Zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Referuar shkronjës “a” dhe “b” të pikës 1, të nenit 20 të Kodit Zgjedhor është parashikuar kompetenca e Komisionit Rregullator për miratimin e rregullave të detajuara për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të referendumeve. Detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje. Referuar paragrafit të katërt, të nenit 12, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Në zbatim të dispozitave të mësipërme, të cilat përcaktojnë kompetencë të Komisionit Rregullator, janë për t’u shqyrtuar dhe miratuar projektaktet e përgatitura, është hartuar dhe projektvendimi i mësipërm. Qëllimi i projektvendimit është detajim i procedurave për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve për zonat e administrimit zgjedhor që do të zhvillohen në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Projektvendimi përmban 5 krerë dhe 23 nene. Në kreun e parë përmban 3 nene, ku përcaktohet qëllimi, detyrat e grupit të numërimit të votave dhe teknologjinë mbështetëse në numërimin e votave. Kreu i dytë trajton procedurën që ndjek ZAZ-ja për marrjen në dorëzim të kutive me fletët e votimit dhe kutinë e materialeve të votimit, ky kre përmban 5 nene dhe trajton detyrat që kryen KZAZ-ja dhe grupet e marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor, verifikimi, klasifikimi i

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

kutive të rregullta dhe të parregullta, si dhe sistemimin e kutive. Kreu i tretë përmban 3 nene dhe trajton veprimet paraprake që ndiqen nga KZAZ-ja për fillimin e procesit të numërimit të votave. Kreu i katërt përmban 10 nene dhe trajton procedurat që ndiqen nga grupet e numërimit të votave, rastet, kriteret për hapjen e kutisë së materialeve të votimit, radhën e veprimit të grupit të numërimit të votave në rastin e hapjes së kutisë së materialeve të votimit, llogaritjes së votave dhe kriteret e vlerësimit të votës, vlerësimin dhe kontestimin, si dhe rivlerësimin e votës së kontestuar, numërimin e votave për çdo kandidat për nxjerrjen e rezultatit për zgjedhjet për kandidat për kryetar bashkie, si dhe mbylljen e kutisë me fletët e votimit. Kreu i pestë përmban dy nene dhe trajton procedurat për nxjerrjen e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja, si dhe hyrjen në fuqi të aktit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Fillimisht çelim diskutimin në parim, pastaj kalojmë nën për nën, duke qenë që kemi këtu edhe drejtorin e Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore, personalisht kam disa gjëra që do duhet t'i pyes në nene konkrete. Parimisht kolegë, lidhur me projektvendimin? Zoti Kaziaj? Në rregull! Atëherë kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Duke qenë që edhe ky vendim është voluminoz, madje më tepër sesa i pari, sipas praktikës së vendosur tashmë nuk do të lexojmë përmbajtjen e neneve, pasi ajo është njoftuar publikisht, u është drejtuar dhe subjekteve zgjedhore, gjithashtu dhe anëtarët e Rregullatorit e kanë marrë paraprakisht.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

Projektvendimet madje gjenden në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që mund të konsultohen edhe nga publiku dhe çdo i interesuar. Fillojmë me shqyrtimin dhe votimin nen për nen të projektvendimit.

Kreu 1. Të përgjithshme. Neni 1. Qëllimi. Kolegë, zoti Kaziaj? Nuk kemi diçka te qëllimi. Kalojmë ne votimin e nenit 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 2. Detyrat e grupit të numërimit të votave. Nuk ka diskutime! Votojmë nenin 2.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 3. Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave, ajo çka ne e kemi miratuar tashmë, teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave më herët, pra përdorimin e kamerave në çdo vend të numërimit të votave dhe video-transmetimin. Ndërkohë, ajo që është shumë e rëndësishme për t'u theksuar në këtë nen është fakti që grupi i numërimit është përgjegjës për të ekspozuar çdo fletë votimi në kamera sipas këtyre procedurave që po miratojmë. Kemi diçka për nenin 3 kolegë? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 3.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kreu 2. Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZAZ-ja.

Neni 4. Caktimi i grupeve të marrjes në dorëzim.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Kush është dakord kolegë, me nenin 4?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 5. Detyrat e grupit të marrjes në dorëzim. Nëse nuk kemi ndonjë koment apo pyetje, apo propozime kalojmë në votimin e nenit 5.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 6. Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor. Është përshkruar në mënyrë të detajuar gjithë procedura e marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore nga grupi i marrjes në dorëzim. Sigurisht besoj që këto rregulla të përcaktuara në këtë vendim për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore do të plotësohen nga udhëzimet e përbashkëta të Komisionerit dhe Nënkomisionerit për marrjen në dorëzim të pajisjes elektronike të identifikimit dhe kamerave. Gjë që ne e kemi autorizuar me një vendim të mëhershëm të Komisionit Rregullator. Në rregull, kalojmë në votimin e nenit 6.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 7. Kutitë e deklaruara. Kuti e parregullt. Është një proces që ndodh në çdo zgjedhje dhe një procedurë e njohur nga ata zyrtarë që kanë qenë edhe më herët, anëtarë të grupeve të numërimit të votave dhe në KZAZ. Sigurisht që kutia e parregullt, është tashmë fakt i ditur që vendoset mënjanë dhe i nënshtrohet një procedure tjetër për hapjen dhe vlerësimin.

Kush është dakord me nenin 7?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 8. Sistemimi i kutive me fletët e votimit dhe kutitë me materiale të votimit në vendet e numërimit të votave. Nuk kemi komente. Kalojmë në votimin e nenit 8.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Para se të kalojmë tek neni 9, më lejoni të theksoj faktin që pas miratimit të këtij vendimi Komisioni Rregullator ka në programin e tij të punës edhe miratimin e një vendimi tjetër, për udhëzuesit e punës, pikërisht të grupeve të numërimit të votave, gjë që do t'u shërbejë, besoj administrata e ka parasysh edhe pjesën e trajnimeve lidhur me grupet e numërimit të votave, prandaj dhe përcaktimi sa më i mirë i rregullave në këtë vendim tonin do të shërbejë për hartimin e një udhëzuesi sa më të qartë për punën e grupeve të numërimit.

Pra, jemi tek kreu 3. Fillimi i procesit të numërimit.

Neni 9. Personat e pranishëm në VNV. Jeni dakord me përmbajtjen e këtij neni, kolegë keni ndonjë pyetje, ndonjë sqarim? Kemi pasur diskutime në zgjedhjet e kaluara lidhur me vëzhguesit? Në fakt janë parashikuar dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, përfaqësuesit e akredituar të mediave, dhe vëzhgues të tjerë të akredituar, përveç sigurisht zyrtarëve të KQZ-së, të KZAZ-së, anëtarëve të GNV-së, personelit teknik, operatorët e teknologjisë mbështetëse, etj.

Kush është dakord me nenin 9?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

Kalojmë në nenin pasardhës, në nenin 10. Veprime paraprake të KZAZ-së. Ndonjë diskutim? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 10.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 11. Fillimi i procesit të numërimit të votave. Një proces, i cili shpresojmë që për këto zgjedhje të jetë një proces i shpejtë, për shkak edhe siç do t'i shohim fletët e votimit, të cilat janë miratuar tashmë në përmbajtje, janë më të thjeshta për t'u vlerësuar nga ana e numëruesve të grupeve të numërimit. Kolegë, votojmë nenin 11! Fillimi i procesit të numërimit të votave.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kreu 4. Procedurat që ndiqen për numërimin e votave nga grupi i numërimit të votave. Neni 12. Veprime paraprake të GNV-së, të grupit të numërimit të votave. Nuk kemi diskutime! Kalojmë në votimin e nenit 12.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 13. Numërimi i votave.

Kush është dakord me nenin 13?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Neni 14. Rastet kur hapet kutia e materialeve të votimit. Zoti Kaziaj, kolegë?
Atëherë, kalojmë në votimin e nenit 14.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 15. Hapja e kutisë së materialeve të votimit. Procedura dhe radha e veprimeve të GNV-së. Edhe ky është një nen i gjatë procedural që parashikon hap pas hapi veprimet e grupit të numërimit të votave gjatë dhe pas hapjes së kutisë së materialeve të votimit. Kolegë? Nëse nuk kemi diskutime, votojmë për nenin 15.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 16. Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës.

Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 16?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 17. Vlerësimi i votave. Unë paraprakisht kisha një pyetje për administratën dhe një kërkesë për të saktësuar diçka. Në pikën 10, të nenit 17 parashikohet se GNV-ja vlerëson shprehjen e vullnetit të votuesit duke iu referuar, por pa u kufizuar në modelet ilustruese bashkëlidhur këtij vendimi. Janë pikërisht ato për të cilat unë edhe më herët përmenda, faktin që bashkëlidhur këtij vendimi kemi disa modele, të cilat janë paraqitur edhe në monitor. Personalisht do doja që të bëhej një ndarje sepse me sa shoh janë modele votash të pavlefshme, por dhe të vlefshme. Kështu që do duhet të kishim një ndarje mes atyre modeleve, pra të

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

titullohen apo të emërtohen, model i votës së pavlefshme, model i votës së vlefshme, që të mos krijojë konfuzion. Nuk e di nëse kolegët e kanë vërejtur? Atëherë, duke qenë që ky vendim do të publikohet në faqen zyrtare, më tej këto modele mund të jenë pjesë e udhëzuesit të grupeve të numërimit të votave. Në variantin që ne kemi të printuar nuk identifikohen votat e vlefshme dhe të pavlefshme. Pra, për mua duhet emërtuar secili model, model i votës së vlefshme, model i votës së pavlefshme. Po, zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Në rastin kur do të zbardhet vendimi, bashkëlidhur vendimit do të vendosen gjithë këto modelet, të cilat ne do t'i miratojmë dhe unë sugjeroj që të mos i shkruhet majtas sipër, po t'i shkruhet poshtë stemës, ose diku tjetër. Pra, në një mënyrë që të jetë e dukshme, vota e vlefshme apo e pavlefshme. Kështu që të jetë si sugjerim për administratën.

Znj. I. Nano: Në rregull! Pra është vetëm çështje saktësimi në modelet që do të publikohen në web dhe që do të jenë si modele pune, orientuese për grupin e numërimit të votave. Përveç kësaj pike unë për nenin 17 nuk kam diçka tjetër, nuk e di kolegët? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 17, me sugjerimin që e thamë më herët, për të bërë këtë saktësim.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 18. Kontestimi dhe rivlerësimi i votës. Nuk kemi mesa shoh pyetje. Kalojmë në votimin e nenit 18.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 19. Numërimi i votave të çdo kandidati për kryetar bashkie. Sigurisht ne e theksuam dhe më herët që në fillim të diskutimit që ky është një projektakt që vjen posaçërisht për këto zgjedhje, dhe ka vetëm një fletë votimi dhe zgjedhjet janë vetëm për kryetarin e bashkisë. Kështu që në këtë kuptim edhe puna e grupeve të numërimit të votave, sigurisht është e ndryshme në raport me aktin e miratuar më herët për zgjedhjet për Kuvend, ku kishim votimin qoftë për subjektet zgjedhore, qoftë për kandidatët e tyre, apo për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Kështu që në këtë rast kemi vetëm numërimin e votave për kandidatët për kryetar bashkie, të cilin do subjekt zgjedhor qofshin. Në rastin konkret ne nuk kemi kandidat në këto zgjedhje të propozuar nga zgjedhësit. Atëherë për nenin 19, kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, kalojmë në votimin e nenit 19.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 20. Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve për kandidatët për kryetar bashkie nga grupi i numërimit për qendrën e votimit. Kolegë, nëse nuk ka pyetje dhe për këtë proces, dhe për këtë nen, kalojmë në votimin e nenit 20.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka


Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 21. Mbyllja e kutisë me fletët e votimit. Nuk ka pyetje, nuk ka sugjerime, as propozime! Kalojmë në votimin e nenit 21.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kreu 5. Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ-ja. Kolegë, kemi diçka për të diskutuar? Në pikën 7 thjesht për vëmendjen e të gjithëve në pikën 7, të nenit 22, është parashikuar një fakt që lidhet me një parashikim të Kodit Zgjedhor, ku ndër të tjera KZAZ-ja ka për detyrë të shpallë kandidatin fitues për kryetar të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Sigurisht në rastet kur një njësi e vetëqeverisjes vendore, siç është rasti i këtyre zgjedhjeve, mbulohet nga më shumë se një KZAZ, siç është Shkodra, Durrësi dhe Lushnja nuk mundet KZAZ-ja, sepse nuk kemi një KZAZ të vetme, prandaj dhe është numërtuar KZAZ-ja nr. 19 Bashkia Dibër, KZAZ nr. 26 Bashkia Vorë, KZAZ nr. 43 Bashkia Rrogozhinë, shpallin kandidatin fitues për kryetar të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mendoni që ka nevojë që për bashkitë e tjera, do të thotë Bashkia Shkodër, Bashkia Durrës, Bashkia Lushnje, mendoni që ka nevojë të vendosim një parashikim për atë se çfarë ndodh me rezultatin?

Znj. H. Vukaj: Sugjeroj t'i dëgjonim zotërinjtë e administratës sesi e kanë menduar këtë proces, për bashkitë që kanë më shumë sesa një KZAZ.

Z. Y. Merkaç: Kodi Zgjedhor e përcakton që për njësitë e qeverisjes vendore që përbëhen nga më shumë se një KZAZ fituesit janë shpallur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Znj. I. Nano: Tani në çdo rast rezultati përfundimtar shpallet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Z. D. Çaka: Kush e shpall?

Z. Y. Merkaj: KQZ-ja, pra!

Z. D. Çaka: Kandidatin fitues?

Z. Y. Merkaj: KQZ-ja, për Shkodrën, Durrësin dhe Lushnjen, shpall rezultatin.

Znj. I. Nano: Shiko, janë dy procese zoti Merkaj, ndaj duam një sqarim. Rezultatin përfundimtar e shpall KQZ-ja, ndërkohë KZAZ-të që mbulojnë shpallin kandidatin fitues, por ky nuk quhet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve, besoj.

Z. Y. Merkaj: Jo, rezultati përfundimtar miratohet nga Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Znj. I. Nano: Po! A ka nevojë po themi, që sikundër kemi pikën 7, që i kemi parashikuar në mënyrë të posaçme për 3 bashkitë, të shtojmë dhe një pikë 8.

Z. Y. Merkaj: Mund të shtojmë pikën 8 që shpallet nga KQZ-ja.

Znj. I. Nano: Pra, kandidatin fitues.

Z. Y. Merkaj: Po, për bashkitë Shkodër, Durrës dhe Lushnje.

Znj. I. Nano: Kush do ishte KQZ-ja në këtë rast?

Z. Y. Merkaj: Është Komisioneri! Për të shpallur rezultatin përfundimtar është Komisioni Rregullator.

Znj. I. Nano: Prandaj le të mos e lëmë KQZ-ja, nëse do ta shtojmë një pikë, të themi...

Z. Y. Merkaç: Po, të themi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Znj. I. Nano: Pra, do vendosim një pikë homologe, ose analoge po themi me pikën 7, por për 3 bashkitë e tjera, të cilat kanë më shumë se një KZAZ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpall kandidatin fitues për 3 bashki, duke iu referuar vetëm bashkive, jo KZAZ-ve, sepse janë më shumë se një. Kolegë, jemi dakord ta shtojmë, ta hedhim në votim këtë propozim për të shtuar një pikë 8, me përmbajtjen që sapo thamë “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shpall kandidatët fitues për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore, në bashkitë Shkodër, Durrës dhe Lushnje”? Votojmë këtë pikë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 23. Hyrja në fuqi dhe ankimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord me nenin 23?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.18.02.2022*

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen në datën 6 Mars 2022”.

Kush është dakord në tërësi?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Miratuam dy projektaktet që kishim për shqyrtim në rendin e ditës. Duke qenë që nuk kemi akt tjetër, por as dhe çështje tjetër për diskutim, më lejoni ta deklaroj mbledhjen të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 21

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

